



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.947/18

Gjykata Themelore ne Mitrovice - Departamenti i përgjithshëm Gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari Gëzim Ademi ne çështjen penale, ndaj te pandehurit B.Ll nga ... me vendbanim rr. “...” nr. ... për shkak te veprës penale: Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 ne lidhje me nenin 18 par 1 pika 1.2 te ligjit për mbrojtje nga dhuna ne familje, sipas Aktakuzës se P.TH. ne Mitrovice PP.II.nr.3986/2018 te datës 07.11.2019, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt. 28.06.2019, ne mungese të PTH, në prezencë te të pandehurit ne te njëjtën dite, e beri shpalljen, ndërsa me datë 12.07.2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: B.Ll, me nofkën “...” nga i ati L., , e ëma L., e gjinisë J., i lindur me ...-ne ... me vendbanim rr.”...” nr. ... ne ..., me numër personal ..., ka te kryer shqetësimin e mesme, i divorcuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, i pa dënuar me pare i gjendjes se mesme, Serb, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me dt. 03.10.2018 pas orës 14:00 ne ... pranë barnatores ai e shkeli Urdhrin mbrojtës i cili është shqiptuar nga ana e gjykatës Themelore ne Mitrovice P.nr.647/18 nga dt. 27.09.2018, ku është aprovuar kërkesa e palës se mbrojtur për ndalimin e shqetësimin, ne atë mënyrë qe edhe meqenëse ekzistonte ky ndalim, ne datën e cekur është afruar pas te dëmtuarës J.G, bashkëshortes se tij te pa kurorëzuar, ka vene dorën ne krahun e saj dhe ka thënë: “mos u inatos përmes fëmijëve, kujdesu se çka bën, nuk te kërcënoj” çka ka te shkaktuar shqetësim dhe frike tek e dëmtuara.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 ne lidhje me nenin 18 par 1 pika 1.2 te ligjit për mbrojtje nga dhuna ne familje.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,41,46,73, dhe 25 ne lidhje me nenin 18 par 1 pika 1.2 , e lidhur me nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-së

GJYKON

ME DENIM ME GJOB, ne shume prej 300(treqind)euro, i cili denim do te ekzekutohet pas plotfuqishmerisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e cekur, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 të KPRK –ës deri zëvendësimin e dënimit me gjobë me denim me burgim duke llogaritur 20 euro (njëzet) euro për një ditë të kaluar me burg

OBLIGOHET i pandehuri qe ti paguaj shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzet)euro, ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te kimit shumen prej 30(tridhjetë) euro, te cilat shpenzime i pandehuri është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmerisë se këtij aktgjykimi.

Për Kërkesën pasurore juridike te dëmtuarit udhëzohen ne kontest te rregull civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë - ka ngritur aktakuzë PP.II.nr. 3986/2018 te datës 07.11.2018, kundër të pandehurit B.L nga Mitrovica, për shkak te veprës penale Shkelja e urdhrin mbrojtës nga neni 25 ne lidhje me nenin 18 par 1 pika 1.2 te ligjit për mbrojtje nga dhuna ne familje.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 28.06.2019 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: se e ndjej veten fajtor për veprën penale për te cilën ngarkohem sipas aktakuzës, me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, dhe ne te ardhmen do te jem i kujdesshëm dhe do te përmbahem dhe nuk do te kryej vepra te tilla penale.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: ne baze te nenit 248 par 2 duke marr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit se janë te përmbushura kushtet ligjore nga paragrafi 1 te këtij neni se pranimi i fajësisë është bere ne mënyrë vullnetare i propozoj gjykatës te pranoj pranimin e fajësisë dhe kjo te merret si rrethane lehtësuese sepse pranimi i fajësisë është mbështetur ne provat materiale qe gjenden ne aktakuzë.

Vlerësimi i pranimin te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimin te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Raporti i policisë Mitrovicë nr. ... nga dt.04.10.2018, urdhrin mbrojtës P.nr.647/2018 te dt. 27.09.2018, aktvendimin për ndalimin e personit te arrestuar nga dt. 04.10.2018, nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Shkelja e urdhrin mbrojtës nga neni 25 ne lidhje me nenin 18 par 1 pika 1.2 te ligjit për mbrojtje nga dhuna ne familje.

Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale. Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese edhe pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale, rrethanë tjetër lehtësuese është edhe fakti se i njëjti nuk figuron ne evidencën e te kaluarës kriminale.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton shqiptimi i dënimit si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, ngase do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale shumen prej 20(njëzet)euro, për fondin e kompensimit te viktimave te krimit shumen prej 30(tridhjetë)euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.947/2018 dt.12.07.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari:
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate